FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.61 2005 3 gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i përbashkët i MRP,MD,PP	Për kushtet, kriteret dhe procedurat e caktimit të masave të përkohshme, të jashtëzakonshme dhe të posaçme të mbrojtjes për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë.....	2229
Udhëzim i përbashkët i MRP,MD,PP	Për detyrat, përgjegjësitë, format dhe procedurat e bashkërendimit e të informimit ndërmjet institucioneve shtetërore.....	2237
Udhëzim i përbashkët i MRP,MD,PP	Për caktimin e kritereve dhe procedurave për ruajtjen, administrimin dhe klasifikimin e informacionit.....	2239
Udhëzim i përbashkët i MRP,MD,PP	Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për mbledhjet e komisionit të vlerësimit të masave të posaçme të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.....	2241
Udhëzim i përbashkët i MRP,MD,MF,PP	Për funksionimin dhe procedurat e punës së Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, si dhe të drejtat, detyrimet dhe trajtimin e anëtarëve të tij……..	2242
Udhëzim i përbashkët i MRP,MD,MF	Për rregullat e administrimit të pasurive dhe fondeve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë……..	2244

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E CAKTIMIT TË MASAVE TË PËRKOHSHME, TË JASHTËZAKONSHME DHE TË POSAÇME TË MBROJTJES PËR DËSHMITARËT DHE BASHKËPUNËTORËT E DREJTËSISË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 8, pikës 4 të nenit 9, pikës 3 të nenit 14, pikës 5 të nenit 10 dhe pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë",

UDHËZOJMË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij udhëzimi janë përcaktimi i hollësishëm i kushteve, kritereve dhe procedurave që duhet të ndiqen për caktimin e masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, për personat e afërm ose të lidhur me ta, që u rrezikohet jeta, shëndeti ose prona, për shkak të ndihmës së dhënë në zbatimin e ligjit penal.

2. Në përmbajtje të këtij udhëzimi, përdoren terma të shkurtuar, të cilat u referohen përcaktimeve në vijim:

Dëshmitar - dëshmitar i drejtësisë;

Bashkëpunëtor – bashkëpunëtor i drejtësisë;

Person i mbrojtur – dëshmitar, bashkëpunëtor ose person i afërt apo i lidhur me ta;

Komisioni - Komisioni i Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes të Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë;

Sektori – Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në përbërje të Drejtorisë së Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, në Ministrinë e Rendit Publik;

Drejtues i Prokurorisë – Drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda, prokurorët e rretheve gjyqësore dhe prokurorët e apelit.

3. Masa të zakonshme të mbrojtjes janë masat për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pasurisë së personit, që parashikohen në ligjin dhe në aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

KREU II
KUSHTET PËR CAKTIMIN E MASAVE TË POSAÇME TË MBROJTJES

4. Kur masat e zakonshme të mbrojtjes çmohen si të papërshtatshme apo të pamjaftueshme për sigurimin e jetës, shëndetit apo pronës së dëshmitarit ose bashkëpunëtorit, ndaj tij zbatohen masa të posaçme të mbrojtjes.

Masat e posaçme nuk mund të vendosen e zbatohen nëse nuk ekziston gjendja e rrezikut aktual, konkret e serioz.

5. Me gjendje rreziku aktual kuptohet një situatë në zhvillim e sipër, e cila vazhdon të rrezikojë jetën, shëndetin apo pronën e dëshmitarit ose bashkëpunëtorit të drejtësisë.

Gjendja e rrezikut nuk duhet të ketë kaluar dhe as të supozohet se mund të ndodhë në të ardhmen.

6. Me gjendje rreziku konkret kuptohet situata kur elemente të veçanta të këtij rreziku kanë filluar të shfaqen dhe mund të shkallëzohen në veprime konkrete kundër dëshmitarit ose bashkëpunëtorit.

7. Me gjendje rreziku serioz kuptohet ajo situatë kur jeta, shëndeti apo prona e dëshmitarit ose bashkëpunëtorit kanosen në mënyrë të tillë që, nëse nuk do të merreshin masat e duhura, do t'iu

shkaktohej një dëm i rëndësishëm.

8. Masat e posaçme vendosen dhe zbatohen kur deklarimet para prokurorit ose policisë gjyqësore, dëshmia ose deklarimet e dhëna para gjykatës, ose nënshkrimi i çdo akti tjetër në përputhje me ligjin procedural penal, pa vendosur kushte apo rezerva për përmbajtjen apo përdorshmërinë e tyre, vlerësohet shumë e rëndësishme për:

a) sigurimin e burimeve të provës apo provave pa të cilat mund të vihej në dyshim një akuzë ose vendim fajësie ndaj të akuzuarve;

b) zbulimin e bashkëautorëve të tjerë në kryerjen e krimit objekt hetimi apo gjykimi;

c) arrestimin e personit ndaj të cilit është lëshuar urdhri i ndalimit apo është vendosur masa e sigurimit "arrest në burg";

d) zvogëlimin e dukshëm të pasojave të shkaktuara nga krimi apo parandalimin e krimeve në përgatitje e sipër;

e) zbulimin e aseteve kriminale të të akuzuarve apo personave të lidhur me ta;

f) krijimin e mundësive për shpërblimin e dëmit të shkaktuar të dëmtuarit nga vepra penale ose trashëgimtarëve të tij;

g) rishikimin e vendimeve që kanë marrë formën e prerë.

Masat e posaçme mund të vendosen para ose pas marrjes së të dhënave nga dëshmitari ose bashkëpunëtori.

9. Masat e posaçme të mbrojtjes nuk mund të vendosen dhe zbatohen kur personi përfitues nuk pranon t'u nënshtrohet këtyre masave ose nuk shpreh vullnetin që të bashkëpunojë për realizimin e tyre.

Akti i shprehjes së vullnetit duhet të jetë akt i shkruar.

10. Persona të afërm të dëshmitarit ose bashkëpunëtorit konsiderohen personat e përcaktuar të tillë në bazë të nenit 2 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë".

11. Persona të lidhur të dëshmitarit ose bashkëpunëtorit konsiderohen personat fizikë ose juridikë për të cilët rezultojnë të dhëna të mjaftueshme që provojnë se pasuritë apo veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga vetë dëshmitari ose bashkëpunëtori.

KREU III
PROCEDURA E MARRJES SË VENDIMIT

12. Prokurori që drejton hetimet paraprake ose që mbron akuzën në gjyq, në rastet kur ka informacione të bazuara ose çmon se, për shkaqe që lidhen me deklarimet para prokurorit ose policisë gjyqësore, dëshminë ose deklarimet e dhëna para gjykatës, ose për shkak të nënshkrimit të çdo akti tjetër në përputhje me ligjin procedural penal, dëshmitari ose bashkëpunëtori duhet të merret në mbrojtje të posaçme, njofton me shkrim drejtuesin e prokurorisë.

Njoftimi ka formën e një relacioni shpjegues për situatën e rrezikut, të cilit i bashkëlidhen:

a) kopje e njësuar me origjinalin e deklarimeve apo e dëshmisë së dhënë;

b) informacionet e mundshme të policisë gjyqësore për gjendjen e rrezikut;

c) certifikatat e lindjes dhe të gjendjes familjare të personit apo personave që propozohen të merren në mbrojtje;

d) çdo dokument tjetër që çmohet i nevojshëm.

Drejtuesi i prokurorisë kur çmon se situata e rrezikut është aktuale, konkrete dhe serioze, i përcjell aktet Prokurorit të Përgjithshëm, duke i kërkuar që të propozojë masa të posaçme mbrojtjeje.

13. Prokurori i Përgjithshëm i propozon Komisionit që të caktojë masa të posaçme të mbrojtjes për dëshmitarin dhe bashkëpunëtorin.

Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm shoqërohet me parashtrimin e të dhënave në vijim:

a) gjeneralitetet, gjendjen familjare, vendbanimin dhe çdo të dhënë tjetër që shërben për identifikimin e personit që propozohet të merret në mbrojtje;

b) të dhëna që përcaktojnë të ardhurat personale dhe familjare, si dhe pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që zotëron ai ose personat e afërm apo të lidhur me të;

c) numrin e procedimit ose të çështjes në gjykim, gjeneralitetet e personave të akuzuar me akuzat përkatëse, gjeneralitetet e personit të dëmtuar, gjendjen dhe shkallën e procedimit;

d) përcaktimin e elementeve mbi bazën e të cilëve gjykohet se kallëzimi, deklarimet apo dëshmia e personit janë të një rëndësie të posaçme për çështjen objekt hetimi apo gjykimi;

e) përcaktimin e elementeve mbi bazën e të cilave gjykohet se personi ndodhet në situatë rreziku aktual, konkret e serioz që lidhet me të dhënat e ofruara prej tij;

f) përcaktimin e të dhënave për personat e tjerë të mundshëm që duhet të merren njëkohësisht në mbrojtje dhe lidhjen e tyre me personin në fjalë;

g) masën konkrete të mbrojtjes së posaçme që gjykohet si më e përshtatshme për rastin konkret;

h) propozimin e mundshëm për marrjen e masave të përkohshme të mbrojtjes, për shkaqe të ngutshme;

i) çdo të dhënë tjetër që çmohet e nevojshme.

Prokurori i Përgjithshëm mund të rezervohet në dhënien e informacioneve të mësipërme, duke arsyetuar nevojën për ruajtjen e sekretit të hetimeve, përderisa me të dhënat nuk është njohur i pandehuri ose mbrojtësi i tij.

14. Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm depozitohet në Sektorin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Ai protokollohet në një regjistër të posaçëm. Numri i protokollit, data dhe ora e mbërritjes në Sektor shënohen në thembrën e shkresës përcjellëse, së bashku me nënshkrimin e protokolluesit.

15. Jo më vonë se 3 ditë nga mbërritja e propozimit, Sektori përgatit materialet që do të merren në shqyrtim nga Komisioni. Propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm i bashkëlidhet një relacion i vlerësimit të gjendjes nga Sektori, me sugjerimet konkrete për zgjidhjen më të përshtatshme.

Materialet i paraqiten kryetarit të Komisionit, i cili ia cakton për relatim njërit prej anëtarëve.

Kryetari cakton ditën e mbledhjes jo më vonë se 2 ditë nga data e paraqitjes së materialeve nga Sektori.

Deri në datën e mbledhjes, relatori ka të drejtë të kërkojë të dhëna shtesë ose sqarime nga Shefi i Sektorit ose specialisti i ngarkuar me ndjekjen e rastit konkret.

16. Rasti objekt shqyrtimi relatohet nga anëtari i ngarkuar prej Kryetarit.

Kryetari i Komisionit dhe anëtarët e tjerë kanë të drejtë të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime.

Lejohet pjesëmarrja në mbledhje e shefit të Sektorit dhe specialistit që ndjek praktikën e propozuar.

Diskutimet e anëtarëve të Komisionit dhe vendimi i marrë pasqyrohen në protokollin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe punonjësi që mban procesverbalin.

17. Në rastet kur në përmbajtje të propozimit dhe të dokumentacionit shoqërues Komisioni konstaton paqartësi lidhur me ekzistencën e situatës së rrezikut, mund t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm të dhëna plotësuese, duke parashtruar faktet për të cilat kërkon sqarime.

Nuk lejohet kërkimi i të dhënave plotësuese më shumë se një herë. Pas plotësimit të tyre, Komisioni është i detyruar të shprehet me vendim.

18. Komisioni shprehet me vendim pranimi ose refuzimi, i cili duhet të arsyetohet.

Vendimi shkruhet nga relatori dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe nga kryetari.

Vendimit i bashkëlidhet mendimi i mundshëm i pakicës.

Për pranimin ose refuzimin e vendimit, si dhe në zgjedhjen e llojit të masës së mbrojtjes së posaçme, Komisioni mban parasysh rëndësinë e të dhënave të siguruara nga personi që merret në mbrojtje, objektin dhe shkallën e rrezikut, rrezikshmërinë shoqërore të personave të akuzuar, gjendjen familjare e financiare, vendbanimin dhe çdo faktor ndikues për zgjedhjen e masës më të përshtatshme.

Vendimi i njoftohet shkresërisht Prokurorit të Përgjithshëm.

Vendimi i njoftohet edhe personit të marrë në mbrojtje të posaçme kundrejt nënshkrimit dhe shënimit të datës së marrjes dijeni në vendim.

Prokurori i Përgjithshëm i dërgon pa vonesë kopje të vendimit drejtuesit të prokurorisë që

ndjek çështjen.

19. Me depozitimin e vendimit, Sektori merr masa të karakterit teknik dhe organizativ për të përgatitur dhe nënshkruar marrëveshjen e mbrojtjes, brenda afatit kohor që cakton neni 16.1 i ligjit.

Përgatitja e marrëveshjes paraprihet nga bisedime me personin e marrë në mbrojtje.

Sektori merr masa dhe dokumenton njoftimin për pjesëmarrje në bisedime të prokurorit që ndjek çështjen.

Personi i mbrojtur njihet me vendimin dhe modalitetet e zbatimit të tij dhe ftohet të plotësojë formularin e të dhënave.

Gjatë bisedimeve, personi i marrë në mbrojtje mund të paraqesë kërkesa, të cilat mund të plotësohen vetëm nëse nuk vijnë në kundërshtim me ligjin.

20. Formulari i të dhënave përgatitet nga Sektori dhe përmban disa rubrika, ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar të dhënat në vijim:

a) gjeneralitetet e personit të marrë në mbrojtje dhe të familjarëve të tij;

b) të dhëna të gjendjes shëndetësore;

c) të dhëna për pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që zotëron individualisht apo në bashkëpronësi;

d) të dhëna për arsimimin, kryerjen e shërbimit ushtarak, eksperiencat profesionale;

e) detajimin e të ardhurave financiare;

f) të dhëna për procedimet penale apo konflikte civile, të zgjidhura me vendim të formës së prerë ose në proces;

g) të dhëna të tjera me interes.

Detajimi i të ardhurave financiare duhet të pasqyrohet për pesë vitet e fundit.

Formulari plotësohet në kopje të vetme dhe administrohet në Sektor.

Sektori ka të drejtë të bëjë verifikimet e nevojshme për saktësinë e të dhënave të deklaruara.

21. Sektori përgatit marrëveshjen e mbrojtjes, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Përpara se të nënshkruhet, marrëveshja e mbrojtjes vihet në dispozicion të prokurorit që ndjek çështjen, i cili jep pëlqimin me shkrim për nënshkrimin e saj.

Prokurori nuk mund të pengojë nënshkrimin e marrëveshjes për shkaqe që nuk janë biseduar në Komision, përveç rastit kur ai ka marrë dijeni për to pas marrjes së vendimit. Në këtë rast, kundërshtimet e prokurorit Sektori ia paraqit për vlerësim Komisionit.

22. Komisioni mblidhet dhe merr në shqyrtim kundërshtimet e prokurorit jo më vonë se tre ditë nga paraqitja e tyre. Prokurori ftohet të marrë pjesë.

Pasi dëgjon prokurorin dhe i merr mendim Sektorit, Komisioni vendos për zbatimin e marrëveshjes ose për riformulimin e termave të saj.

KREU IV
PËRMBAJTJA E MARRËVESHJES SË MBROJTJES DHE NDJEKJA E ZBATIMIT TË SAJ

23. Marrëveshja e mbrojtjes është një kontratë me detyrime të dyanshme, e lidhur me vullnet të lirë dhe të pavesuar, me palë kontraktuese Sektorin dhe personin e mbrojtur.

Kjo marrëveshje përmban detyrimisht të drejtat e detyrimet e palëve, kohëzgjatjen e zbatimit të masave dhe rrethanat e ndryshimit apo të heqjes së tyre.

Ajo hartohet në kopje të vetme që ruhet në Sektor.

24. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe mbaron në rastet e mëposhtme:

a) kur mbaron afatit i parashikuar në marrëveshje;

b) kur personi i mbrojtur ose Sektori, pas miratimit nga Komisioni, tërhiqet në mënyrë të

njëanshme;

c) kur vdes personi i mbrojtur;

d) kur përfundon gjendja e rrezikut për të cilin është marrë masa e posaçme e mbrojtjes.

Vdekja e personit të mbrojtur nuk paragjykon vazhdimin e zbatimit të marrëveshjes për personat e afërt ose të lidhur me të.

Për mbarimin e marrëveshjes njoftohet me shkrim prokurori.

25. Para fillimit të zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes, Sektori i bën të njohura edhe njëherë personit të mbrojtur të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga programi i mbrojtjes, pasojat në rast shkelje të marrëveshjes dhe i kërkon që të nënshkruajë deklaratën e mëposhtme:

"Deklaroj se jam në dijeni të plotë të marrëveshjes për mbrojtjen dhe të të drejtave e detyrimeve që burojnë prej saj. Jam sqaruar hollësisht për kuptimin e dispozitave të veçanta të kësaj marrëveshjeje dhe zotohem ta zbatoj atë me korrektësi. Jam plotësisht dakord me përmbajtjen e saj, fakt të cilin e vërtetoj duke nënshkruar këtë deklaratë."

26. Sektori ka këto të drejta dhe detyrime:

a) të marrë të gjitha masat e nevojshme me karakter teknik e organizativ për të ofruar mbrojtje të përshtatshme, në përputhje me shkallën dhe nivelin e rrezikut;

b) të mbikëqyrë në vijimësi respektimin e kushteve të marrëveshjes;

c) të mbajë kontakte të vazhdueshme me personin e mbrojtur;

d) të sigurojë kushtet për plotësimin e të gjitha kërkesave të ligjshme të personit të mbrojtur;

e) t'i ofrojë falas shërbime mjekësore të zakonshme dhe të specializuara nëpërmjet shërbimit të posaçëm në Ministrinë e Rendit Publik;

f) të sigurojë marrjen e masave që personi i mbrojtur të përmbushë detyrimet e tij ndaj organeve të drejtësisë, duke siguruar zhvendosjen, transportimin dhe akomodimin e tij në kohën e duhur.

Personi i mbrojtur ka këto të drejta e detyrime:

a) të pranojë t'ju nënshtrohet masave që Sektori i çmon të nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës së tij;

b) të kallëzojë, deklarojë dhe dëshmojë me vërtetësi para policisë gjyqësore, prokurorit dhe gjykatës, sa herë që të jetë e nevojshme, pa kushte e rezerva, lidhur me faktet objekt hetimi apo gjykimi për të cilat ka dijeni;

c) të ruajë sekretin lidhur me të gjitha faktet për të cilat ka marrë dijeni gjatë zbatimit të programit të mbrojtjes, edhe pas tërheqjes apo mbarimit të tij;

d) të ndërpresë menjëherë kontaktet me personat e dyshuar për veprimtari kriminale, si dhe me persona të tjerë, takimet me të cilët mund të rrezikojnë programin e mbrojtjes;

e) të mos kryejë veprimtari që e ekspozojnë ndaj rrezikut, apo që bien ndesh me qëllimet e zbatimit të programit të mbrojtjes;

f) të mos keqpërdorë dokumentet mbuluese dhe të njoftojë menjëherë Sektorin, në rast humbje apo vjedhjeje të tyre;

g) të bëjë përpjekje për të shlyer të gjitha detyrimet ndaj personave fizikë ose juridikë, të mbartura prej tij para përfshirjes në programin e mbrojtjes;

h) të mos keqpërdorë programin e mbrojtjes për të mbuluar pjesëmarrjen në veprimtari kriminale;

i) të pranojë që të bashkëpunojë me Sektorin, në interes të mbrojtjes së tij, duke ndihmuar për zbatimin e masave të përshtatshme teknike që realizojnë vëzhgimin, përgjimin e bisedimeve dhe komunikimeve telefonike apo elektronike, si dhe kontrollin dhe manipulimin e korrespondencës së tij me persona të tretë;

j) të bëjë përpjekje për të siguruar të ardhurat e nevojshme për përballimin e jetesës;

k) të ekonomizojë ndihmën financiare të ofruar nga Sektori, pa lejuar shpenzime të panevojshme apo të tepërta;

l) të respektojë masat e marra nga autoritetet e huaja kur zbatimi i programit të mbrojtjes kryhet në territorin e një shteti tjeter.

27. Ndjekja e zbatimit të programit të mbrojtjes kryhet nga Sektori.

Për ecurinë e zbatimit të programit, Sektori informon Komisionin, jo më pak se një herë në tre muaj.

28. Masat e posaçme të mbrojtjes mund të ndryshohen ose të hiqen, kur personi i mbrojtur shkel një ose disa nga kushtet e marrëveshjes së mbrojtjes, të parashikuara shprehimisht në përmbajtje të saj, kur pushojnë shkaqet që kanë diktuar lidhjen e saj, si dhe me kërkesën e tij.

29. Sektori i kërkon Komisionit ndryshimin ose heqjen e masave, duke parashtruar arsyet ku mbështetet kërkesa.

Kërkesa shoqërohet me gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Ajo paraqitet jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes dijeni për shkeljen e kryer, e konstatimit të shkakut që dikton ndryshimin, apo e depozitimit të kërkesës nga personi i interesuar.

Komisioni merr në shqyrtim kërkesën jo më vonë se 5 ditë, duke filluar nga e nesërmja e paraqitjes së saj.

Zbatohen, për aq sa është e mundur, rregullat e parashikuara në nenet 15 – 18 të këtij udhëzimi.

30. Sektori mund t'i propozojë Komisionit heqjen e masave mbrojtëse, në rastet e mëposhtme:

a) kur mbaron afati i parashikuar në marrëveshje dhe nuk janë kushtet për zgjatjen e vlefshmërisë së saj;

b) kur pushojnë shkaqet e rrezikut që kanë diktuar lidhjen e saj:

c) kur personi i mbrojtur refuzon të deklarojë apo të dëshmojë ose kur nga verifikimi i thënieve të tij del se ka bërë kallëzim, deklarime apo dëshmi të rreme;

d) kur gjatë ripyetjes ndryshon përmbajtjen e kallëzimit, deklarimit ose dëshmisë së dhënë;

e) kur pas fillimit të zbatimit të programit të mbrojtjes, ndaj tij ngrihet akuzë për një vepër penale, të kryer me dashje, gjatë kohës që është nën mbrojtje;

f) kur pas fillimit të zbatimit të programit të mbrojtjes, ndaj tij ngrihet akuzë për një vepër penale, të kryer me dashje, para se të kishte filluar programi i mbrojtjes, por të padeklaruar në shpjegimet e tij;

g) kur provohet se ka paraqitur të dhëna të rreme lidhur me pasuritë dhe të ardhurat financiare;

h) kur refuzon të bashkëpunojë me Sektorin për zbatimin e marrëveshjes së mbrojtjes;

i) kur refuzon masat e marra nga Sektori me qëllim sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës së tij dhe të të afërmve të tij;

j) kur kryen veprime që përbëjnë rrezik për të dhe për të afërmit e tij, ndonëse është këshilluar nga Sektori për ndërprerjen e tyre;

k) kur refuzon ose braktis, pa shkaqe të arsyeshme, punën e ofruar apo veprimtaritë që sjellin të ardhura ekonomike;

l) kur autoriteti i huaj njofton mbarimin e masave të zbatuara prej tij dhe nuk çmohet se duhet të merren masa mbrojtëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

31. Sektori mund t'i propozojë Komisionit ashpërsimin apo zbutjen e masave mbrojtëse, në rastet kur ndryshojnë kushtet që kanë diktuar marrjen e tyre.

32. Personi që u është nënshtruar masave mbrojtëse të posaçme, mund t'i kërkojë Sektorit ndryshimin ose heqjen e tyre, duke parashtruar motivet ku mbështetet kërkesa.

Kërkesa shqyrtohet nga Komisioni, i cili merr vendim për pranimin ose refuzimin e saj.

33. Vendimi për ndryshimin apo heqjen e masave mbrojtëse të posaçme i njoftohet prokurorit jo më vonë se tre ditë, duke filluar nga e nesërmja e marrjes së vendimit.

KREU V
LLOJET E MASAVE TË POSAÇME TË MBROJTJES

34. Ndryshimi i identitetit është masë e posaçme mbrojtjeje, e cila konsiston në pajisjen e personit të mbrojtur dhe familjes së tij me dokumente identifikimi të ndryshuara.

Për realizimin e kësaj mase, Sektori bashkëpunon me entet shtetërore e private për të siguruar përgatitjen e dokumenteve fiktive, regjistrimet përkatëse në regjistrin themeltar të shtetasve në Zyrat e Gjendjes Civile, si dhe ndryshimet përkatëse në dokumentacionin e çdo zyre tjetër.

Të drejtat dhe detyrimet e Sektorit dhe të enteve shtetërore e private rregullohen me marrëveshje të veçanta.

Ndryshimet në identitetin e personit të mbrojtur dhe familjarëve të tij pasqyrohen në një regjistër të veçantë, i cili ruhet në Sektor.

35. Ndryshimi i vendbanimit është masë e posaçme mbrojtje, e cila konsiston në zhvendosjen e personit të mbrojtur dhe familjes së tij nga vendbanimi i njohur drejt një vendbanimi të ri, brenda të njëjtit rreth, në një rreth tjetër, ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shpenzimet e zhvendosjes dhe pagimi i qirasë së banesës përballohen nga fondi i Sektorit.

Në rastet e zhvendosjes jashtë shtetit shpenzimet caktohen në marrëveshje me palën pritëse.

36. Mbrojtja e përkohshme e identitetit është masë e posaçme mbrojtje, e cila konsiston në fshehjen e gjeneraliteteve të personit të mbrojtur në fazën e hetimeve paraprake, si dhe gjatë dhe pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Për realizimin e kësaj mase, Sektori bashkëpunon me prokurorin, duke i dhënë personit një identitet fiktiv, me ose pa regjistrim në regjistrat e Zyrës së Gjendjes Civile. Ndryshimet pasqyrohen në regjistrin e posaçëm të Sektorit.

Sektori merr masa që gjatë dëshmisë së tij, personi i mbrojtur të jetë i shoqëruar fizikisht. Mund të merren masa për ndryshimin e pamjes fizike.

Lejohet përdorimi i aparaturave që realizojnë ndryshimin e zërit.

37. Me masa të mbrojtjes fizike kuptohet tërësia e masave për të siguruar mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës së personit të marrë në mbrojtje dhe njerëzve të afërt apo të lidhur me të.

Për sigurimin e mbrojtjes fizike, lejohet përdorimi i mjeteve teknike të interceptimit dhe vëzhgimit.

Për përmbushjen e detyrimeve ndaj drejtësisë personi i mbrojtur lëviz i shoqëruar nga Reparti Special i Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Personave të Veçantë.

38. Masa të posaçme të karakterit financiar janë:

a) kontributi për pagimin e qirasë së banesës;

b) kontributi për mbulimin e shpenzimeve për transferimin;

c) kontributi për mbulimin e nevojave të familjes derisa personi i mbrojtur dhe familjarët e tij të gjejnë një punë të re;

d) kontributi për rikualifikimin profesional;

e) kontributi për pagesat e ndihmës ligjore.

39. Shpenzimet e karakterit financiar duhet të përligjen me paraqitjen e faturës. Kur kjo nuk është e mundur, për shkaqe që lidhen me sigurinë e personit apo për shkaqe të tjera të arsyeshme, mjafton deklarimi i shpenzimeve i miratuar nga shefi i Sektorit.

Tërheqja e të hollave në arkë nuk duhet t'i referohet personit të mbrojtur. Në çdo rast përdoret një kod i paracaktuar.

Dokumentacioni dhe kodi i zgjedhur vendosen në fashikullin e praktikës, së bashku me aktet që kanë vendosur, zgjatur apo ndryshuar masat e posaçme të mbrojtjes.

Paguhen shpenzimet për kryerjen e kurseve të kualifikimit kur, për shkaqe që lidhen me mbrojtjen e personit apo me rrethana të tjera, personi nuk mund të ushtrojë dot profesionin e mëparshëm.

Paguhen të gjitha shpenzimet e domosdoshme që kryhen me qëllim rehabilitimin dhe reintegrimin shoqëror të personit të mbrojtur dhe të personave të afërm ose të lidhur me të, të vendosur në program mbrojtje.

Paguhen shpenzimet e kryera për mbrojtjen ligjore. Kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet në rastet e proceseve penale, civile apo administrative që nuk kanë lidhje me faktin për të cilin personi është marrë në mbrojtje.

Lejohet pagesa e shpenzimeve për konsultime juridike dhe për ndihmën psikologjike të personit të mbrojtur, i cili thirret të dëshmojë në gjyq. Ndihmë psikologjike mund t'i ofrohet edhe bashkëpunëtorit të drejtësisë.

40. Masat mbrojtëse për personat e paraburgosur apo që vuajnë dënimin me burgim ekzekutohen në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Lejohet mbajtja e personit të mbrojtur në regjim të veçantë, pa lejuar kontakt fizik me personat e paraburgosur ose të dënuar.

Lejohet transferimi i personit të mbrojtur për shkaqe sigurie.

Personi në regjim mbrojtje mund të përfitojë takime jashtë rradhe me familjarët e tij dhe lehtësi të tjera që parashikojnë rregulloret.

Zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes për personat e paraburgosur ose të dënuar mbikëqyret nga prokurori.

KREU VI
MASAT E PËRKOHSHME TË MBROJTJES

41. Masat e përkohshme të mbrojtjes janë masa që merren për shkaqe të ngutshme, me afat të caktuar dhe që ekzekutohen menjëherë, me qëllim që të sigurojnë paraprakisht nivelin e domosdoshëm të mbrojtjes për jetën, shëndetin dhe pronën e personit të mbrojtur, deri në vendosjen e masave të posaçme të mbrojtjes.

42. Masat e përkohshme të mbrojtjes vendosen nga Sektori me kërkesë të arsyetuar të drejtuesit të prokurorisë ku është regjistruar procedimi, në të cilin personi që kërkohet të merret në mbrojtje ka cilësinë e dëshmitarit apo të bashkëpunëtorit të drejtësisë.

Sektori shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se 24 orë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Vendimi i Sektorit nuk është i vlefshëm pa pëlqimin paraprak, të dhënë me shkrim, nga personi që do të mbrohet.

Vendimi i Sektorit nuk mund të vihet në ekzekutim pa miratimin e njëkohshëm të kryetarit të Komisionit dhe të Prokurorit të Përgjithshëm ose të një prokurori të autorizuar prej tij.

43. Masa të përkohshme të mbrojtjes janë:

a) shoqërimi për mbrojtjen e afërt fizike;

b) marrja në ruajtje e banesës ose e pronës.

Mbrojtje të përkohshme, në varësi nga kushtet e rrezikut, mund të përfitojnë edhe personat e afërt ose të lidhur me personin e mbrojtur.

Mbrojtja e personit dhe e pronës së tij, në varësi nga kushtet e rrezikut, kryhet për intervale të caktuara kohore ose në mënyrë të pandërprerë gjatë 24 orëve.

44. Masat e përkohshme të mbrojtjes nuk mund të zgjatin më shumë se 30 ditë.

Brenda këtij afati kohor Komisioni duhet të marrë vendim për caktimin e masave të posaçme të mbrojtjes.

Masat e përkohshme mbarojnë me vendosjen e masave të posaçme të mbrojtjes.

KREU VII
MASAT E JASHTËZAKONSHME TË MBROJTJES

45. Masat e jashtëzakonshme të mbrojtjes janë masa që merren për shkaqe të ngutshme, me afat të caktuar dhe që ekzekutohen menjëherë, me qëllim që të sigurojnë paraprakisht nivelin e domosdoshëm të mbrojtjes për jetën, shëndetin dhe pronën e shtetasve, të paraburgosurve ose të dënuarve, deri në vendosjen e masave të posaçme të mbrojtjes.

46. Masat e jashtëzakonshme të mbrojtjes vendosen nga Policia e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe drejtoria e institucioneve të paraburgimit apo të vuajtjes së dënimit.

Ato i njoftohen menjëherë dhe jo më vonë se 24 orë nga marrja e tyre drejtuesit të Prokurorisë që ndjek çështjen dhe Sektorit.

Vendimi për caktimin e tyre duhet të jetë i arsyetuar.

47. Masa të jashtëzakonshme të mbrojtjes janë masat e parashikuara nga nenet 41 dhe 44 të këtij udhëzimi, si dhe çdo masë tjetër e parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e organeve që kanë të drejtë të vendosin këto masa.

48. Masat e jashtëzakonshme të mbrojtjes nuk mund të zgjatin më shumë se 15 ditë, me të drejtë rizgjatje për një periudhë tjetër 15 -ditore.

Zgjatja e afatit duhet të miratohet nga Sektori dhe prokurori i çështjes.

Brenda këtij afati kohor Komisioni duhet të marrë vendim për caktimin e masave të posaçme të mbrojtjes.

Masat e jashtëzakonshme mbarojnë:

a) kur zhduket gjendja e rrezikut që ka diktuar marrjen e tyre;

b) kur vendosen masa të posaçme të mbrojtjes.

KREU VIII
HYRJA NË FUQI

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR DETYRAT, PËRGJEGJËSITË, FORMAT DHE PROCEDURAT E BASHKËRENDIMIT E TË INFORMIMIT NDËRMJET INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 11 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë",

UDHËZOJMË:

1. Institucionet e sigurisë kombëtare dhe organet shtetërore, kur përfshihen në procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, për zbatimin e ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", bashkëpunojnë me Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Rendit Publik, Ministrinë e Drejtësisë, Sektorin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Komisionin për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

2. Institucionet dhe organet shtetërore bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë njoftime dhe informacione jo vetëm për personat që janë përfshirë në programin e mbrojtjes, por edhe për personat e afërm ose të lidhur me ta.

3. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësise ka të drejtë t'i bëjë pyetje e propozime Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, institucioneve qendrore, organeve të pushtetit e të administratës dhe të kërkojë prej tyre shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës për mbrojtjen e personit që do të merret në mbrojtje. Këto organe janë të detyruara t'i shqyrtojnë pyetjet e propozimet e bëra dhe t'i përgjigjen Komisionit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tyre.

4. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë iu parashtron organeve përkatëse kërkesat, ankesat, vërejtjet dhe propozimet e bëra nga personat e mbrojtur. Këto organe duhet t'i marrin në shqyrtim dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes të njoftojnë Komisionin për mënyrën e zgjidhjes së tyre.

5. Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë brenda 7 ditëve, nga dita që Komisioni ka marrë përgjigjen nga organet përkatëse, duhet të informojë personin e mbrojtur për mënyrën e zgjidhjes së kërkesave ose ankesave, masave të marra ose për motivet e mospranimit.

6. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë kur vëren se nëpunësi apo punonjës të ndryshëm nuk i kryejnë detyrat apo shkelin ligjin dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" kërkon nga organet kompetente marrjen e masave përkatëse ndaj personave fajtorë. Këto organe janë të detyruara që brenda 15 ditëve të shqyrtojnë kërkesën dhe të njoftojnë Komisionin për masat që kanë marrë.

7. Organi kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të bashkëpunëtorëve të drejtësisë është Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë. Këto kërkesa dhe ankesa Komisionit i përcillen nga organet drejtuese të administratës së burgjeve, ku bashkëpunëtori vuan dënimin.

8. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në çdo rast njofton dhe mund të kërkojë ndërhyrjen e organeve eprore të institucioneve që janë të ngarkuara me zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të

tij, për të mbikëqyrur ekzekutimin, si dhe për të kryer verifikimet përkatëse duke marrë masa të menjëhershme për konstatimet e vërejtura dhe kërkesat e Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

9. Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë menjëherë pas paraqitjes së propozimit sipas nenit 13 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" vendos kontakte me personat e afërm ose të lidhur me personin për të cilin është propozuar zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes, si dhe mund të kërkojë nga organet shtetërore informacion shtesë mbi përshtatshmërinë e personave për përfshirjen e tyre në masat e posaçme të mbrojtjes.

10. Për ndryshimin, heqjen ose përfundimin e masave të posaçme të mbrojtjes, pas marrjes së vendimit nga Komisioni, Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë sipas rastit njofton me shkrim Prokurorin.

Në rastet e heqjes ose përfundimit të masave të posaçme të mbrojtjes, Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë njofton strukturat e Policisë së Shtetit për vendbanimin/vendqëndrimin e personit të cilit i janë hequr ose përfunduar masat e mbrojtjes. Strukturat e Policisë së Shtetit marrin masa të zakonshme mbrojtje të mjaftueshme për përballimin e rreziqeve, të mundshme, nëse rreziqet bëhen konkrete, aktuale dhe serioze për jetën këto struktura i drejtohen për vlerësim nëpërmjet informacioneve të hollësishme Prokurorit të Përgjithshëm.

11. Vendimet e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë i njoftohen Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë me njoftime të veçanta, në të cilat nuk bëhen të ditura të dhëna për kontributin e bashkëpunëtorit dhe procedimin penal. Në njoftim Sektori detajon detyrimet e organeve shtetërore, si dhe mënyrën e zbatimit të vendimit të Komisionit. Kjo procedurë ndiqet edhe për vendimet e Komisionit, të cilat ndryshojnë, heqin ose përfundojnë masat e posaçme të mbrojtjes.

12. Në rastet kur personi i mbrojtur është shtetas i huaj, refugjat apo person pa shtetësi Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme duhet të informojë dhe koordinojë veprimet për t'i krijuar personit lehtësitë e nevojshme për komunikim me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë në Republikën e Shqipërisë, të shtetit të cilit ai i përket, përfaqësuesit të shtetit që merr përsipër mbrojtjen e interesave të tyre, ose autoritetet kombëtare apo ndërkombëtare, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të këtyre personave.

13. Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në çdo rast bashkëpunimi me prokurorin e procedimit penal, në të cilin personi i mbrojtur ka dhënë kontributin e tij bashkëpunues, mbi bazën e marrëveshjes, do të synojë përcaktimin e drejtë të përgjegjësive, të drejtave, detyrimeve dhe efektet e marrëveshjes sipas neneve 16 e 17 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë".

14. Për përdorimin e dokumenteve identifikuese fiktive për personat e mbrojtur, pas administrimit të autorizimit me shkrim nga Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, shefi i Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë u kërkon organeve kompetente ekzemplarë të bardhë/ të paplotësuar të kartave të identitetit dhe të dokumenteve të tjera të identifikimit.

15. Bashkëpunëtorët e Drejtësisë që vuajnë dënimin me burgim, duke mos përjashtuar klauzolën e vullnetit të bashkëpunimit, sistemohen në institucione ose seksione të veçanta të tyre të përcaktuara posaçërisht me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

16. Drejtuesit e institucioneve të vuajtjes së dënimit me burgim/paraburgim janë të detyruar të njoftojnë Sektorin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë për çdo kërkesë dhe ankesë të bashkëpunëtorit, sipas ligjit nr.8328 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim". Komunikimi dhe kontaktet e personelit të Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë me bashkëpunëtorët që vuajnë dënimin me burgim ose janë të paraburgosur janë të pakufizuara.

17. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, strukturat përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë,

prokurorët e Gjykatave të Shkallës së Parë dhe prokurorët e Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR CAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR RUAJTJEN, ADMINISTRIMIN DHE KLASIFIKIMIN E INFORMACIONIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë",

UDHËZOJMË:

1. Informacion në kuptim të këtij udhëzimi do të kuptohet çdo njohuri që mund të komunikohet apo dokumentohet, pavarësisht nga forma dhe që është nën kontrollin e Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

2. Me klasifikim do të kuptohet akti apo procesi nëpërmjet të cilit një informacion përcaktohet si i klasifikuar.

3. Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, që krijojnë, prodhojnë e administrojnë informacione të klasifikuara "sekret shtetëror", bëjnë klasifikimin e informacionit dhe dokumenteve në mbështetje me ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"".

4. Punonjësit e Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë duhet të pajisen me "certifikatë sigurie", në mbështetje me ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"" nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

5. Nivelet e klasifikimit janë:

a) "Tepër sekret", kur ekspozimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme veçanërisht të rënda procesit të zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes.

b) "Sekret", kur ekspozimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme serioze procesit të zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes.

c) "Konfidencial", kur ekspozimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme procesit të zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes.

6. Dokumentacioni i Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe i Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë administrohet në sekretari–arkivin e këtij sektori.

7. Hyrja në Sektorin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, përveç punonjësve që punojnë në këtë sektor, bëhet me autorizim. Autoriteti që lëshon autorizimin për hyrjen në Sektor është Drejtori i Drejtorisë së Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve.

8. Pranë Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë krijohet me urdhër të titullarit "Komisioni i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" dhe i deklasifikimit e zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror". Përbërja e këtij komisioni është më jo më pak se 5 anëtarë.

9. Komisioni i shqyrtimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" shqyrton llojet e dokumentacionit që prodhon sektori dhe propozon atë kategori dokumentesh që duhen klasifikuar, rivlerësuar, nivelin e klasifikimit dhe afatin e ruajtjes së këtij niveli.

10. Deklasifikimi i dokumenteve duhet të bëhet pasi të ketë mbaruar programi i zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes me një afat pas 10 vjetësh.

11. Informacioni dhe dokumentacioni që do të trajtohet nga Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në asnjë rast nuk do të ketë nivel më të ulët se

konfidencial.

12. Në rastet kur gjatë administrimit nga personat e autorizuar, nga informacioni i klasifikuar shkëputen pjesë të caktuara, informacioni i përfituar do të ruajë të njëjtin nivel klasifikimi si informacioni i parë.

13. Kur një informacion është i klasifikuar e gjithë praktika ku bën pjesë ai klasifikohet në nivelin e këtij informacioni.

14. Kur në një praktikë të informacioneve të klasifikuara bën pjesë një informacion i klasifikuar në një nivel më të lartë, e gjithë praktika do të marrë nivelin e dokumentit me klasifikim më të lartë.

15. Për sa nuk parashkruhet në këtë udhëzim do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"" dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe zbatim të tij.

16. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe prokurorët e Gjykatave të Shkallës së Parë dhe prokurorët e Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR MBLEDHJET E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË MASAVE TË POSAÇME TË MBROJTJES SË DËSHMITARËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 8 të nenit 6 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë"

UDHËZOJMË:

1. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpuntorëve të Drejtësisë, me poshtë i quajtur "Komisioni", është organi i cili ushtron kompetencat e parashikuara në ligjin nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë".

2. Anëtarë të Komisionit janë ata persona të cilët emërohen sipas paragarfit 2 të nenit 6 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" dhe që plotësojnë kriteret e parashikuara në paragrafin 4 të nenit 6 të ligjit të sipërcituar. Këta persona pajisen me certifikatë sigurie, nga Departamanti i Informacionit të Klasifikuar. Po i njëjti kriter u aplikohet anëtarëve alternativë.

3. Kryetari i Komisionit, ose në mungesë të tij zëvendëskryetari, thërret mbledhjen brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës nga Prokurori i Përgjithshëm, duke njoftuar për datën, vendin dhe orën e mbledhjes, të gjithë anëtarët e Komisionit. Në njoftimin me shkrim që u dërgohet anëtarëve të Komisionit, u jepet bashkëlidhur rendi i ditës dhe dokumentet, të cilat do të diskutohen në të. Njoftimi anëtarëve të Komisionit u dërgohet në zarf të mbyllur me mbishkrimin "konfidencial".

4. Njoftimi për mbledhje u dërgohet edhe anëtarëve alternativë të Komisionit, duke respektuar të njëjtat procedura dhe formë të dërgimit të dokumentacionit. Anëtarëve alternativë u dërgohet vetëm ftesa për datën dhe orën e mbledhjes, dhe në rast se anëtari, të cilin anëtari alternativ duhet ta zëvendësojë, nuk merr pjesë në mbledhje, atëherë atij i dërgohet edhe dokumentacioni tjetër.

5. Në rast të kërkesave urgjente dhe për raste të veçanta, kërkesat e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij udhëzimi nuk respektohen dhe njoftimi mund të bëhet nëpërmjet telefonit apo faksit, në

asnjë rast mbledhja nuk duhet të jetë më vonë se 24 orë nga marrja e kërkesës.

6. Dokumentacioni i kërkuar nga ligji nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", përgatitet nga Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, më poshtë i quajtur "Sektori", dhe i vihet në dispozicion kryetarit të Komisionit, i cili bën shpërndarjen e tij nëpërmjet Sektorit. Kur zhvillohen mbledhje urgjente dhe për raste të veçanta, dokumentacioni u vihet në dispozicion anëtarëve në momentin e zhvillimit të mbledhjes.

7. Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të marrin pjesë në mbedhjet e tij, eprorët direkt, apo punëdhënënësit e tyre nuk duhet t'u nxjerrin pengesa për pjesëmarrje në to. Anëtari nuk merr pjesë në mbledhje vetëm për arsye objektive, dhe në këto raste njofton urgjentisht kryetarin e Komisionit dhe Sektorin, në mënyrë që këta të fundit të marrin masa për të njoftuar anëtarin alternativ.

8. Mbledhjet zhvillohen në vendin e përcaktuar në njoftim dhe drejtohen nga kryetari i Komisionit. Të drejtën për të marrë pjesë në mbledhje, përveç anëtarëve të Komisionit e kanë përgjegjësi i Sektorit dhe specialistët e Sektorit, përfaqësues të autorizuar të Prokurorit të Përgjithshëm. Ata thirren në mbledhje kur një gjë të tillë e çmojnë të arsyeshme anëtarët e Komisionit, për të dhënë shpjegime apo sqarime rreth çështjeve që diskutohen apo për dokumente të ndryshme. Personat e ftuar nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhje gjatë procesit të votimit.

9. Me fillimin e mbledhjes kryetari i Komisionit u kërkon anëtarëve të Komisionit, menjëhere pas deklarimit të hapjes së seancës, të deklarojnë nën përgjegjësinë e tyre nëse ekziston ndonjë nga shkaqet e përmendura në nenin 6 pika 7 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitareve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", që pengojnë ushtrimin e funksionit.

10. Nëse ndonjë nga shkaqet e përmendura në pikën 9 pengon arritjen e kuorumit të nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, kjo e fundit shtyhet për jo më tepër se 24 orë, duke zëvendësuar anëtarin e penguar me zëvendësin alternativ të tij.

11. Komisioni, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, ka vulën e vet, me këtë sigël:

- Stema e Republikës së Shqipërisë,
- Republika e Shqipërisë,
- Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR FUNKSIONIMIN DHE PROCEDURAT E PUNËS SË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E MASAVE TË POSAÇME TË MBROJTJES SË DËSHMITARËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË, SI DHE TË DREJTAT, DETYRIMET DHE TRAJTIMIN E ANËTARËVE TË TIJ

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 7 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë", për përcaktimin e procedurave të punës së Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, si dhe të drejtat, detyrimet dhe trajtimin e anëtarëve të tij

UDHËZOJMË:

I. Dispozita të përgjithshme.

Organet përgjegjëse për përgatitjen, vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë janë:

a) Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

b) Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

II. Dispozita të veçanta.

1. Ky udhëzim përcakton mënyrën e funksionimit dhe procedurat e punës së Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, që më poshtë do të quhet "Komisioni".

2. Komisioni është organi përgjegjës për vlerësimin, miratimin dhe zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

3. Komisioni ka për detyrë të organizojë dhe ushtrojë kontroll fizik e dokumentar mbi programin e mbrojtjes. Gjithashtu kërkon nga zbatuesit informacion mbi masat e posaçme të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

4. Komisioni për rastet që konstaton se propozimi për vendosjen e masave të posaçme të mbrojtjes ndaj dëshmitarit apo bashkëpunëtorit të drejtësisë nuk është i plotë, ka të drejtë që të kërkojë dokumente ose informacione të tjera plotësuese.

5. Komisioni mbi bazën e dokumentacionit dhe informacioneve të paraqitura, nisur dhe nga ekspozimi i rrezikut aktual, konkret dhe serioz, mund të vendosë masa të posaçme mbrojtje të ndryshme nga ato të kërkuara në propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

6. Komisioni merr vendime jo më vonë se 10 ditë nga mbledhja e parë dhe në çdo rast jo më vonë se 30 ditë nga depozitimi i dokumentacionit përkatës dhe i propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm.

7. Aktet dhe çdo informacion për veprimtarinë e Komisionit konsiderohen informacion i klasifikuar.

8. Komisioni përcakton afatin kohor të masave të posaçme të mbrojtjes para, gjatë dhe mbas hetimit të çështjes penale. Komisioni përcakton afatin kohor të masave të posaçme të mbrojtjes jo më pak se 6 muaj dhe jo më shumë se 5 vjet. Ky afat vendoset në të njëjtin akt me të cilin përcaktohen masat e posaçme të mbrojtjes.

Në rast se Komisioni nuk shprehet për afatin kohor të masave të posaçme të mbrojtjes, atëherë masat e posaçme të mbrojtjes zbatohen nga Sektori për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë për një afat kohor prej 1 (një) viti që nga dita e miratimit të masave të posaçme të mbrojtjes.

9. Komisioni do të zgjasë masat e posaçme të mbrojtjes duke përcaktuar një afat të ri kohor në qoftë se e shikon të arsyeshme dhe mbi bazën e dokumentacionit që disponon për këtë rast.

Komisioni në zbatim të neneve 19 e 20 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë", miraton ndryshimin, revokimin ose përfundimin e zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes.

10. Mbledhjet e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë janë të vlefshme kur janë të pranishëm tre anëtarë të tij.Vendimet e tij janë të vlefshme kur miratohen nga tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

11. Komisioni bashkëpunon me komisionet analoge të vendeve të tjera për këmbimin e përvojës në fushën e programeve të mbrojtjes.

12. Aktet, dokumentacioni dhe çdo informacion që lidhet me aktivitetin e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë konsiderohet informacion i klasifikuar që mbahet dhe administrohet nga Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

13. Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësise njofton personat e interesuar për Vendimin e Komisionit mbi propozimin.

14. Në mbledhjet e Komisionit mund të marrë pjesë edhe Drejtori i Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, varësi të të cilit është edhe Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

15. Komisioni për punën që kryhen përfiton shtesë mbi pagë. Shtesa mbi pagë jepet nga institucioni nga i cili ose për shkak të të cilit është emëruar kryetari dhe anëtarët e këtij Komisioni. dhe

varion: Kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë 20 000 (njëzetë mijë) lekë në muaj dhe anëtarët e Komisionit 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj dhe jepet nga institucioni nga i cili është emëruar kryetari dhe anëtarët e këtij Komisioni.

16. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

17. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.5.2005.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR RREGULLAT E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE DHE FONDEVE TË NEVOJSHME PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË MBROJTJES SË DËSHMITARËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË.

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, nenit 4 pika 4 dhe nenit 5 germa "e" të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë", me qëllim administrimin, menaxhimin dhe përdorimin me efektivitet të fondeve

UDHËZOJMË:

I. Dispozita të përgjithshme

"Dëshmitar i drejtësisë", "Bashkëpunëtor i drejtësisë", "Persona të afërm", "Persona të lidhur","Persona të mbrojtur" dhe "Gjendje rreziku", i referohen nenit 2 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë".

II. Dispozita të veçanta

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, janë:

a) Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

b) Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

III. Planifikimi i fondeve buxhetore

1. Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve te Drejtësisë në funksion të programit të posaçëm të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, harton projektbuxhetin, i cili pasi miratohet nga drejtori i Luftës Kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve i paraqitet brenda datës 10 gusht, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Buxheti në dispozicion të këtij sektori është zë i veçantë, në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe çelet me program financiar, që fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Ai detajohet në 4 dhe 2-mujor dhe depozitohet në degën e buxhetit Tiranë për zbatim.

3. Kërkesa për buxhet i referohet nenit 10 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" dhe programohet në baze të:

- numrit të rasteve (dëshmitarëve të drejtësisë) me masa të posaçme të mbrojtjes me efekte financiare, faktit të shpenzimeve të vitit paraardhes dhe 6-mujorit të vitit ushtrimor;
- nivelit të taksave dhe tarifave për shërbimet ndaj të tretëve për rastet e ndryshimit të identitetit, vendbanimit, shërbimit mjekësore brenda vendit dhe jashtë vendit, rikualifikimit profesional, dhënies së këshillave dhe të ndihmës së specializuar ligjore etj);
- numrit të rasteve që trajtohen me ndihmë financiare, referuar limitit financiar dhe kohës ndërmjet dy punësimeve, numrit të apartamenteve të marra me qira për banim brenda dhe jashtë vendit

dhe tarifës mujore të likuidimit të tyre,

- numrit të apartamenteve të marra me qira brenda dhe jashtë vendit për punë profesionale (operative) dhe tarifës mujore të likuidimit të tyre;

- krijimit dhe përmirësimit të infrastrukturës (inventarit të pajisjeve) dhe të materialeve të tjera specifike për punë operative etj.

Në kërkesën për buxhet do të përllogaritet edhe fondi për akomodimin dhe trajtimin financiare të personave të huaj, kjo në bazë të marrëveshjeve sipas reciprocitetit (Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe shteteve përkatëse).

Pjesë përbërëse e buxhetit të Sektorit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, do të jenë edhe fondet me burim financimi nga sponsorizimet vetëm nga donatorë të huaj.

Detajimi i këtyre fondeve do të bëhet sipas përcaktimit të donatorit. Procedura e çeljes në degën e buxhetit është e njëjtë si për fondet buxhetore.

IV. Niveli i aplikimit të taksave, tarifave dhe ndihmës financiare

1. Niveli i shpenzimeve për rastet e ndryshimit të identitetit, vendbanimit, shërbimit mjekësor brenda dhe jashtë vendit, rikualifikimit profesional, dhënies së këshillave e të ndihmës së specializuar ligjore etj.) do të jetë ai i përcaktuar në legjislacionin financiar, si ligji për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë, ligji për sistemin e taksave vendore, urdhrave të Ministrit të Rendit Publik, Ministrit të Shëndetësisë, Ministrit të Drejtësisë etj., për aplikimin e tarifave për shërbimet që u ofrohen të tretëve.

2. Limiti i shpenzimeve për ndihmën financiare për "Dëshmitarin e drejtësisë", për kohën ndërmjet dy punësimeve do t'i referohet, gjendjes financiare përpara përfshirjes në programin e mbrojtjes.

3. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, miraton rast pas rasti limitin (shumën në lekë) për personat e përcaktuar në këtë ligj, si më poshtë:

a) Për personat që nuk kan qenë në marrëdhënie pune dhe për të miturit, ndihma financiare nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale në shkallë vendi e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe jo më shumë se 2.5 herë të kësaj page.

b) Për personat e punësuar në institucionet shtetërore apo kompanitë private, limiti minimal do të jetë i barabartë me pagën neto të përfituar muajin e fundit, përpara përfshirjes në programin e mbrojtjes dhe jo më shumë se 1.5 herë të kësaj page.

c) Për personat që përfitojnë pension të pjesshëm, invaliditeti ose pension të plotë pleqërie para përfshirjes në programin e mbrojtjes, bëhet rimbursimi i shumës përkatëse, referuar limitit financiar minimal dhe maksimal të përcaktuar në germën "a" të këtij udhëzimi.

Vlera absolute e rimbursimit, si për nivelin minimal apo atë maksimal, evidentohet dhe miratohet në marrëveshjen që nënshkruhet nga personi i përfshirë në programin e mbrojtjes dhe nga përfaqësuesi i Sektorit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

ç) Në rastet kur, përveç dëshmitarit të drejtësisë, përfshihen në programin e posaçëm të mbrojtjes edhe personat e afërm, ku sipas përcaktimeve të nenit 16 të Kodit të Procedurës Penale si rregull, banojnë ose bashkëjetojnë në mënyrë të qëndrueshme me të, limiti i ndihmës financiare për çdo person të marrë në mbrojtje, do të jetë i barabartë me nivelin e pagës minimale në shkallë vendi të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për raste të veçanta me propozim të Komisionit dhe me miratim të Ministrit të Rendit Publik, niveli i ndihmës financiare për personat e përcaktuar në gërmën "a" dhe "c" të pikës tre të këtij udhëzimi do të jetë 3 herë më i madh se niveli i pagës minimale në shkallë vendi dhe 3 herë të pagës neto të muajit të fundit për personat e punësuar në institucionet shtetërore apo kompanitë private.

Propozimi për rritjen në vlerë të ndihmës financiare, duhet të jetë i argumentuar dhe të parashikojë efektet që priten nga kjo rritje.

Niveli i ndihmës (limiti) financiare i përcaktuar në këtë udhëzim zbatohet edhe për personat e afërm apo të lidhur me bashkëpunëtorin e drejtësisë.

4. Për dëshmitarët e drejtësisë, personat e afërm dhe personat e lidhur që do të akomodohen jashtë vendit, Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, miraton limitin financiar në valutë, (USD, euro, etj.) sipas monedhës

së vendit përkatës dhe nuk mund të jetë më i vogël se minimumi jetik në këto vende.

Ndërsa për rastet e marrjes (përfshirjes) në një program mbrojtjeje, të dëshmitarit dhe të personave të afërm (neni 16 i Kodit të Procedurës Penale) niveli i ndihmës (limiti) financiare për çdo person do të jetë sa paga minimale e vendit (shtetit) ku janë akomoduar dëshmitarët e drejtësisë.

5. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë miraton tarifën për marrjen me qira të apartamenteve ose banesave për dëshmitarët e drejtësisë dhe personat e afërm të tyre. Në përcaktimin e tarifës Komisioni i referohet sipërfaqes në m^2, pajisjeve që duhet të posedohen në këto ambiente, tarifave që publikohen në median e shkruar nga axhensitë imobilare dhe përshtatshmërisë së tyre në funksion të sigurisë etj. Mbi këtë bazë Komisioni miraton tarifën mujore apo vjetore.

Likuidimi i shpenzimeve për marrjen me qira të apartamenteve apo banesave përballohet nga buxheti i vënë në dispozicion të Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë. Kurse shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm do të likuidohen sipas faturave që lëshohen nga institucionet përkatëse dhe do të përballohen nga niveli i ndihmës financiare që përfiton personi i marrë në mbrojtje.

Një gjë e tillë fiksohet në marrëveshjen që nënshkruhet ndërmjet personit të marrë në mbrojtje dhe përfaqësuësit të Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

Për rastet e zbatimit të masave të përkohshme të mbrojtjes, niveli i taksave, tarifave dhe ndihmës financiare për personat e mbrojtur, miratohet nga kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

V. Procedura e zbatimit të buxhetit

1. Çelja e planit të buxhetit për fondin e konsoliduar dhe atë nga të ardhurat dhe sponsorizimet (vetëm me donatorë të huaj) bëhen në nivel titulli (034) kapitulli (1; 5 dhe 6) dhe artikulli dhe përfaqësojnë limitin maksimal të lejuar për t'u zbatuar.

2. Raportimi mujor i shpenzimeve faktike nga dega e thesarit, bëhet sipas klasifikimit ekonomik, funksional dhe organizativ dhe sipas procedurave të thesarit. Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve dhe i të ardhurave është ai i përcaktuar në manualin e klasifikimit ekonomik buxhetor të miratuar nga Ministri i Financave.

3. Dega e thesarit në bazë të planit të dërguar nga dega e buxhetit, miraton dokumentacionin financiar (çek dhe urdhërpagesë etj.) për kryerjen e shpenzimeve. Në këtë dokumentacion përveç shënimeve standarde evidentohet vetëm përshkrimi i veprimit "Shpenzime sekrete të Sektorit për Mbrojtjen Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë".

Miratimi i dokumentacionit në degën e thesarit bëhet nga një punonjës i autorizuar për këtë qëllim dhe nga kryetari i degës së thesarit, Tiranë.

4. Mënyra e rakordimit, evidentimit në librat e kontabilitetit, menaxhimit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve do të jetë konform kërkesave të ligjit organik "Të Buxhetit të Shtetit", udhëzimit të Ministrit të Financave "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit", ligjit "Për kontabilitetin" dhe nenit 14 të urdhrit të Ministrit të Rendit Publik nr.2087, datë 15.3.2005 "Për funksionimin dhe organizimin e Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë".

VI. Administrimi i pasurisë

1. Administrimi i pasurisë do të kryhet sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin dhe planin unik kontabël të miratuar nr.248, date 10.3.1998 të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Struktura dhe klasifikimi kontabël analitik i pasurisë do të jetë konform planit unik kontabël.

3. Për administrimin e pajisjeve speciale (që ndodhen në apartamentet e marra me qira), krahas evidentimit në llogari, të plotësohen kartelat (skeda), ku të evidentohen karakteristikat teknike dhe të dhënat vlerore, si vlera kontabël bruto, shuma e amortizimit, vlera kontabël neto dhe vlera e riparimit të pajisjes.

4. Administrimi i pasurisë duhet të sigurojë:

- Ruajtjen dhe administrimin e pasurisë në përdorim;
- Regjistrimin kronologjik të të gjitha dokumenteve në librat e kontabilitetit;
- Ruajtjen e të dhënave dhe disponimin e tyre në çdo kohë;
- Kontrollin e plotë të gjendjes sasiore e cilësore të pasurisë dhe lëvizjet e saj;
- Përgatitjen e dokumenteve përmbledhëse dhe nxjerrjen e të dhënave të nevojshme për

hartimin e programit material e financiar dhe kontrollin e realizimit të tij.

5. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, sipas rastit miraton edhe mënyrën e administrimit të pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme të personave të marrë në mbrojtje. Një gjë e tillë evidentohet në marrëveshjen që nënshkruhet me personin e marrë në mbrojtje.

VII. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

VIII. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.4.2005.

Fletorja Zyrtare gjendet:
Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 3.8.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë